

# AXHENDA E GJELBËR E SHPJEGUAR

Prill 2022

[www.facebook.com/BalkansUnitedforCleanAir](https://www.facebook.com/BalkansUnitedforCleanAir)

## BALLKANI I BASHKUAR PËR AJËR TË PASTËR



1

DEKARBONIZIMI: VEPRIMI PËR KLIMËN,  
ENERGJINË E PASTËR DHE  
TRANSPORTIN E QËNDRUESHËM

2

EKONOMIA  
QARKULLUESE

3

LUFTA KUNDËR NDOTJES SË UJIT,  
AJRIT DHE TOKËS

4

PRODIMI I USHQIMIT TË  
SHËNDETSHËM

5

BIODIVERSITETI: MBROJTJA DHE RESTAURIMI  
I NATYRËS DHE EKOSISTEMEVE

## HYRJE

Axhenda e Gjëlber për Ballkanin Perëndimor është një instrument për arritjen e Marrëveshjes së Gjëlber Evropiane në rajonin tonë. Marrëveshja e Gjëlber Evropiane përfaqëson një moment historik në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe një strategji gjithëpërfshirëse të rritjes së Bashkimit, dhe zbatimi i saj duhet të çojë në neutralitetin klimatik të Bashkimit Evropian deri në vitin 2050. Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes mbi Axhendën e Gjëlber për Ballkanin Perëndimor më 10 nëntor 2020, vendet e rajonit u angazhuan për zbatimin e Axhendës së Gjëlber si një "udhërrëfyes" për një sërë veprimesh dhe masash konkrete për të çuar në një zhvillim me karbon të ulët dhe rritje ekonomike në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Axhenda e Gjëlber për Ballkanin Perëndimor mbulon pesë fusha: klimën, energjinë dhe lëvizshmërinë; ekonominë qarkulluese; parandalimin e ndotjes; bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; dhe biodiversitetit.

## ÇFARË ËSHTË AXHENDA E GJELBËR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR?

Për të kuptuar Axhendën e Gjëlber për Ballkanin Perëndimor, ne duhet të kuptojmë Marrëveshjen e Gjëlber Evropiane. Kjo e fundit është një strategji zhvillimi afatgjatë e vendeve të BE-së, e cila synon parandalimin e ndryshimeve klimatike. Ne mund ti shohim tashmë pasojat e ndryshimeve klimatike në natyrë, nga shkrija e mbulesës polare dhe akullnajave, rritja e shpejtë e nivelit të detit, valët intensive të të nxehtit, shfaqja e sëmundjeve të reja dhe zhdukja masive e specieve të ndryshme bimore dhe shtazore. Faktori kryesor për këto efekte anësore që ndikojnë në mjedisin tonë është emetimi i gazeve serrë, përkatësisht ato që si një batanije mbajnë nxehtësinë në atmosferën e Tokës dhe në këtë mënyrë ngrohin planetin. Prandaj, qëllimi kryesor i Marrëveshjes së Gjëlber është arritja e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050, pra neutralizimi i plotë i sasisë së gazeve serrë që emetojmë në atmosferë.

## ÇFARË DO TË THOTË E GJITHË KJO PËR BALLKANIN?

Rajoni ynë është një nga më të rrezikuarit ndaj pasojave negative të ndryshimeve klimatike

## RRITJE E TEMPERATURËS

Nëse do kishit shpikur një makinë kohe dhe do të ktheheshit në vende të ndryshme në Ballkanin Perëndimor 100 vjet më parë, ju do mund të përjetonit temperatura jashtëzakonisht të larta. Imagjinoni të përjetoni 44.9 gradë Celsius në Beograd (më 18 qershor 1918)? Nëse kjo nuk mjafton, shtoni pak më shumë dhe ndaloni në Mostar më 31 korrik 1901 - 46,2 gradë! 100 vjet më vonë, këto temperatura ekstreme u bënë më të zakonshme. Në shekullin e 20-të, banorët e Sarajevës po përjetonin temperatura ekstreme mesatarisht rreth gjysmë dite në vit (0,6 ditë). Në shekullin e 21-të, ata përballeshin me 4,3 ditë në vit me vapë ekstreme. E njëjta situatë është edhe në Tiranë, ku gjatë shekullit të kaluar mund të përjetonit 1,6 ditë me vapë ekstreme në vit, ndërsa tani është deri në 6,6 ditë në vit. Megjithatë, nëse duam të përdorim

makinën tonë të kohës dhe të udhëtojmë drejt së ardhmes në fund të shekullit të 21-të, do të ishim dëshmitarë të një skene nga filmat fantastiko-shkencor. Duke pasur parasysh rritjen aktuale të emetimeve të gazeve serrë, rajoni i Ballkanit Perëndimor do të goditet nga një rritje befasuese e temperaturës prej 5 gradë. Kjo do të nënkuptonte një ngrohje të atillë që Toka nuk e ka parë që nga Epoka e fundit e Akullit, pasi sot planeti është 5°C më



# #BallkaniiBashkuar

i ngrohtë se në atë periudhë. Në të ardhmen e afërt, ne presim një shfaqje graduale të një klime subtropikale në veri të rajonit të Ballkanit Perëndimor, ndërsa rajonet jugore dhe bregdetare do të preken nga periudha të zgjatura të valëve të të nxehtit, si dhe një verë e zgjatur, deri në dy muaj. Kjo mund të tingëllojë argëtuese për entuziastët e detit dhe notit, por reaksionet zinxhir

që shoqërojnë ndryshime të tilla (si thatësira dhe përmbytjet, mungesa e ujit të pijshëm dhe ushqimit) sigurisht që nuk janë; Përveç blerjes së rrobave verore, duhet të marrim edhe ato të papërshkueshme nga uji.

## PËRMBYTJET



## Parapërgatitje për Ajërtë Pastër

NPërkatesisht, temperaturat ekstreme shoqërohen me stuhi verore, kështu që tashmë jemi dëshmitarë të reshjeve ditore të barabarta me sasinë mesatare totale të reshjeve gjatë gjithë muajit. Infrastruktura e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk mund t'i rezistojë reshjeve të tilla të papritura; shkaktojnë përmbytje, duke prekur transportin, sistemin shëndetësor, si

dhe prodhimin bujqësor. Qytetarët e Ballkanit ende i kujtojnë përmbytjet katastrofike të vitit 2014 që prekën vendbanime të tëra në Serbi, Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci. Krahas reshjeve të mëdha, dukuritë zinxhir të shkaktuara nga ndryshimet klimatike përfshijnë zjarret dhe thatësitrat. Zjarret intensive kanë goditur Shqipërinë dhe një problem shtesë kanë qenë zonat e paarritshme, të vështira për t'u arritur nga mjetet zjarrfikëse. Tashmë prej disa vitesh thatësitrat po prekin rajonin duke shkaktuar pasoja të mëdha materiale. Për shkak të uljes së nivelit të ujit në liqenet natyrore dhe artificiale, Maqedonia e Veriut u detyrua të importojë energji elektrike nga jashtë vitin e kaluar, e cila kushtoi afër 3.5 milionë euro. Ndërmjet viteve 1950 dhe 2000, Serbia ka përjetuar tre vite jashtëzakonisht të thata, ndërsa në njëzet vitet e ardhshme parashikohen deri në shtatë vite. Gjatë kësaj periudhe 20-vjeçare, Serbia ka pësuar një dëm të pabesueshëm prej 7.5 miliardë eurosh për shkak të kushteve ekstreme të motit. Pasojat e rritjes graduale të temperaturës ndodhin si një reaksion zinxhir dhe sjellin ndryshime të mëdha në ekosistemet, dhe në të gjitha speciet bimore dhe shtazore, veçanërisht në lidhje me përhapjen dhe shumicën e tyre. Parashikohet që kushtet ekstreme të motit dhe çdo rritje e temperaturës prej 0,5°C do të dyfishojnë prevalencën e mushkonjave të infektuara me virusin e Nilit Perëndimor<sup>1</sup>.

## SI I PËRGJIGJET AGJENDA E GJELBËR KËTYRE SFIDAVE?

Për shkak të të gjithave sa më sipër, lufta kundër ndryshimeve klimatike është një çështje e mbijetesës sonë dhe Axbenda e Gjellbër është një mënyrë për ta realizuar atë dhe për t'u përshtatur me kushtet e ndryshuara klimatike.

Axbenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor përbëhet nga 5 shtylla:

- 1) Dekarbonizimi: veprimi për klimën, energjinë e pastër dhe transportin e qëndrueshëm
- 2) Ekonomia qarkulluese
- 3) Lufta kundër ndotjes
- 4) Prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit dhe zona të qëndrueshme rurale
- 5) Biodiversiteti: mbrojtja dhe restaurimi i natyrës dhe ekosistemeve

## 1. DEKARBONIZIMI: VEPRIMI PËR KLIMËN, ENERGINË E PASTËR DHE TRANSPORTIN E QËNDRUESHËM

Dekarbonizimi nënkupton reduktimin gradual dhe heqjen e plotë të përdorimit të lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë dhe kalimin në burime të pastra, të rinovueshme, të pakufizuara dhe të qëndrueshme të energjisë. Duke djegur lëndët djegëse fosile, ne rrisim përqendrimin e gazeve serrë dhe në këtë mënyrë kontribuojmë në ndryshimet klimatike, ndërkohë që prodhojmë sasi të mëdha ndotjeje që emetohen në ajër, ujë dhe tokë, duke rrezikuar shëndetin e të gjithë qytetarëve, stabilitetin e ekosistemeve natyrore, furnizimin dhe aksesin në përdorimin e ujit dhe prodhimin e ushqimit.

Prandaj, veprimi ndaj ndryshimeve të klimës është bërë një temë e nxehtë

<sup>1</sup> <https://klima101.rs/virus-zapadnog-nila-klimatske-promene/>

(si figurativisht dhe në kuptimin e plotë të fjalës). Me siguri keni dëgjuar për Marrëveshjen e Parisit, e cila është nënshkruar nga pothuajse të gjitha vendet e botës, të cilat kanë rënë dakord të mbajnë rritjen mesatare globale të temperaturës nën 1.5-2°C. Pse janë të rëndësishme këto shifra? Shkenca thotë se një rritje e temperaturës globale prej 2°C do të thotë se 411 milionë njerëz të tjerë në zonat urbane do të ekspozohen ndaj mungesës së ujit. Kjo është një shifër pothuajse 24 herë më e madhe se popullsia e sotme e të gjitha vendeve të rajonit së bashku. Një rritje prej 2°C e temperaturës globale do të thotë se një e pesta e numrit të përgjithshëm të insekteve do të asgjësohet, gjë që do të ketë pasoja të pakthyeshme për prodhimin bujqësor. Një rritje e temperaturës globale prej 2°C do të thotë se 37% e popullsisë së planetit tonë do të ekspozohet ndaj valëve të forta të të nxehtit<sup>2</sup>.

Emetimet e gazeve të dëmshëm – dhe ndotja e ujit, ajrit dhe tokës – shkaktohen kryesisht nga qymyri, të cilin në Ballkan e përdorim kryesisht për prodhimin e energjisë. Ky shkëmb sedimentar është vendimtar për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes. Megjithatë, qymyri është një nga burimet më ndotës të energjisë dhe kalimi në energjinë e rinovueshme është një parim kyç i Axhendës së Gjellbër. A keni parë ndonjëherë se si duket peizazhi gjatë dhe pas minierave të qymyrit? Pellgje të mëdha mbeturinash qymyri të zinj, re të errëta tymi që rrinë pezull mbi oxhakët e termocentraleve dhe qytetarët që vuajnë nga astma dhe sëmundje të tjera. Nga ana tjetër, i njëjti peizazh i shkatërruar mund të zëvendësohet me panele solare që thithin energjinë diellore, të shoqëruara nga një mori turbinash me erë. Energjia e pastër nga burime të rinovueshme, si era dhe dielli, e disponueshme për të gjithë, e cila nuk ndot mjedisin, nuk rrezikon shëndetin e njeriut apo sistemin klimatik – ky është qëllimi i Axhendës së Gjellbër. Në këtë foto të dytë, nuk keni nevojë

të jeni vetëm një vëzhgues pasiv, ju mund të përfshiheni drejtpërdrejt në prodhimin e energjisë! Kështu, për shembull, ju mund të bashkoni forcat me bashkëqytetarët tuaj, të krijoni një organizatë energjetike në qytetin tuaj dhe të ndërtoni së bashku një park me panele diellore. Në këtë mënyrë, ju merrni energji për shtëpitë tuaja dhe me kalimin e kohës ulni koston e energjisë elektrike, pasi ajo prodhohet vetë tani. Kjo është edhe një mundësi për të demokratizuar sistemin energjetik, sepse qytetarët bëhen pjesëmarrës aktivë dhe pronarë të energjisë në vend të konsumatorëve të thjeshtë, gjë që ka ndodhur deri më tani.

Hapi kryesor duhet të jetë “heqja” e qymyrit nga lista jonë e pagesave. Sigurisht, kjo nuk mund të bëhet brenda natës. Një orë në mëngjes vlen dy në mbrëmje, kështu që duhet menduar me kujdes se si komunitetet e varura nga industria e qymyrit mund të kenë një fillim të ri. Reduktimi gradual dhe eliminimi eventual i subvencioneve të qymyrit është në përputhje me Axhendën e Gjellbër, duke pasur parasysh pasojat socio-ekonomike që do të

kishte një tranzicioni i tillë në popullsinë që varet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga industria e qymyrit. Kjo do të thotë se nuk mjafton vetëm të mbështeten kompanitë që po kalojnë nga lëndët djegëse fosile në burimet e rinovueshme të energjisë – por duhet të sigurohet që shumë banorë në rajonet prodhuese të qymyrit që mund të humbasin punën e tyre në sektorin e energjisë tani mund të punësohen në industri të tjera. Një ish-minator, puna e të cilit shkaktohej thithjen e ajrit të ndotur, duke bërë që shëndeti i tij të përkeqësohej dita-ditës, tani mund të punojë në shtimin e biokarburanteve në të ardhmen e afërt, në sektorin e pylltarisë së qëndrueshme, si teknik i paneleve diellore ose në turizmin rural – këto janë të gjitha degë të ekonomisë që mund të mbushin boshllëkun e krijuar nga një minierë e braktisur qymyri. Përveç dërgimit të qymyrit “në pension të merituar”, ne gjithashtu duhet të “dëbojmë me forcë” karburantet fosile nga shtëpitë tona. Axhenda e Gjellbër parashikon gjithashtu ndihmë për qytetarët në kalimin në alternativa më të pastra për ngrohjen e shtëpive dhe në tejkalimin e varfërisë energjetike, e cila është një nga shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit në rajon.

Kursimet financiare që arrihen me përdorimin e qymyrit si për prodhimin e energjisë elektrike ashtu edhe për ngrohjen janë thjesht një iluzion sepse nuk kemi një pamje realiste të të gjitha kostove të shkaktuara nga përdorimi i qymyrit. Ka kosto të fshehura, të cilat manifestohen si shëndeti i dëmtuar dhe jetëgjatësi e shkurtuar e qytetarëve tanë, reduktim i produktivitetit në punë, ditë të kaluara në pushim mjekësor dhe presion mbi sistemin shëndetësor – dhe kjo faturë për Ballkanin Perëndimor mund të arrijë deri në 8.5 miliardë euro. Ne nuk jemi aq të pasur sa të vazhdojmë të përdorim zgjidhje të lira!

“Dalja në pension” e qymyrit nuk do të ngadalësojë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, siç besojnë disa. Përmirësimi i standardeve të të gjithë rajonit mund

të arrihet më shpejt, më pastër dhe më sigurt me burimet e rinovueshme të energjisë. Për shembull, Bashkimi Evropian ka reduktuar emetimet e tij të gazeve serrë me pothuajse një të katërtën në 30 vitet e fundit, ndërkohë që ka arritur një rritje ekonomike prej 60%<sup>3</sup>.

Ka një rrugë të gjatë për të bërë për të përmbushur qëllimin e dekarbonizimit, ndaj është e rëndësishme ta bëjmë atë sa më komod të jetë e mundur. Ndërtimi i linjave hekurudhore rajonale, përmirësimi i transportit lumor dhe zbatimi i sistemeve të transportit inteligjent me qëllim të përmirësimit të logjistikës dhe uljes së ndotjes – këto janë parimet e Axhendës së Gjellbër që synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Kohët e fundit, është bërë e zakonshme që të përdorim telefonat tanë për të caktuar një takim për kartën e identitetit – tashmë jemi njohur me përfitime të tilla të dixhitalizimit. Sidoqoftë, imagjinoni që po planifikoni një udhëtim biznesi në një vend fqinj në telefonin tuaj inteligjent, që përfshin rezervimin e një autobusi elektrik që



#BallkaniBashkuarPërAjertëPastër

<sup>2</sup> <https://www.ipcc.ch/sr15/chapter/chapter-3/>

<sup>3</sup> [https://ec.europa.eu/clima/eu-action/climate-strategies-targets/progress-made-cutting-emissions\\_en](https://ec.europa.eu/clima/eu-action/climate-strategies-targets/progress-made-cutting-emissions_en)

ndalon para shtëpisë tuaj. Më pas në rrugën e kthimit vendosni të shmangni turmat në pikën kufitare duke planifikuar një udhëtim me varkë në Danub për të shkuar në qytetin tuaj. Ju dilni menjëherë në stacionin e biçikletave dhe zhblokoni biçikletën tuaj nëpërmjet aplikacionit dhe pas disa ushtrimeve fizike të këshilluara mirë, ktheheni në shtëpi të freskuar në mbrëmje.

Një hap tjetër i rëndësishëm kur bëhet fjalë për ndryshimet klimatike është përshtatja me ndryshimin e klimës që tashmë ka ndodhur. Ajo tashmë po shkakton fatkeqësi të motit me intensitet të lartë dhe qytetarët e rajonit tonë shpesh përballen me përmbytje të mëdha dhe thatësira të gjata. Përshtatja kërkon që njerëzit të mendojnë përpara. Si rrjedhim, ekziston nevoja për të vlerësuar se cilat zona mund të përmyten, cilët lumenj mund të vërshojnë, në mënyrë që të ndërtohen mure më të larta për të parandaluar përmbytjet ose për të zvogëluar intensitetin e tyre. Gjithashtu, duke qenë se thatësitrat janë bërë shumë të shpeshta në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duhet të

përdoret një planifikim i mirë dhe të përdoren sezonet e përmbytjeve për të krijuar rezerva ujore, të cilat mund të përdoren më vonë nga fermerët për të ujitur fushat e tyre. Axhenda e Gjelbër ofron një kornizë për këto aktivitete në rajon.

## 2. EKONOMIA QARKULLUESE

Në natyrë, gjithçka qarkullon; çdo gjë pasi merret kthehet dhe përdoret përsëri. Në natyrë, çdo gjë ka qëllimin e saj dhe asgjë nuk humbet, gjithçka përdoret plotësisht. Për shembull, gjatë jetës së tij, një lis i madh merr ujë nga natyra (të cilin e lëshon në atmosferë përmes gjetheve), përdor dritën e diellit dhe minerale të shumta nga toka. Kur një pemë bie në pyll, ajo ngadalë dekompozohet dhe bëhet ushqim për insektet, kërpudhat dhe më pas për mikroorganizmat. Mikroorganizmat dekompozojnë mbetjet e pemës, duke



**#BallkaniiBashkuarpërAjertëPastër**

e kthyer atë në ushqim, minerale, humus dhe tokë pjellore në të cilën tani mund të rriten pemë të tjera. Dhe cikli i jetës vazhdon.

Ndryshe nga ekonomia e natyrës, e jona nuk i kthen burimet natyrës. Përkundrazi, ne i marrim, i përdorim dhe i hedhim në vendgrumbullime, ku burimet bëhen mbetje dhe rrezik për shëndetin, duke ndotur mjedisin. Ne shohim pasojat e një modeli të tillë ekonomik dhe menaxhimit të mbetjeve në të gjithë Ballkanin, nga lumenjtë plot me 'ishuj plastikë', fusha dhe pyje të kthyer në vendepozitime ilegale, deri te landfillet që janë gjithnjë e më të prirura ndaj zjarreve dhe shkaktojnë probleme serioze të ndotjes së ajrit, si p.sh. Zjarri i Vinçës në verën e vitit 2021.

Shtylla e dytë e Axhendës së Gjelbër është ekonomia qarkulluese, e cila nënkupton përpjekjen për të kursyer dhe për të qenë të kujdesshëm me burimet që marrim nga natyra. Ekonomi qarkulluese do të thotë që ajo që marrim nga natyra si lëndë e parë qëndron në përdorim për aq kohë sa të jetë e mundur dhe që më pas, ose përdoret për qëllime të tjera ose riciklohet. Ose, si zgjidhje e fundit – e depozitojmë në landfill, si mbetje. Kjo do të thotë që kur planifikojmë një produkt, marrim parasysh të gjithë ciklin e tij jetësor dhe pyesim veten: sa lëndë e parë na nevojitet për atë produkt, sa energji dhe ujë përdorim për prodhimin e tij, sa mbetje gjenerojmë gjatë prodhimit dhe çfarë do të bëjmë me ato mbeturina. Le të shqyrtojmë, për shembull, si të bëjmë një frigorifer që do të zgjasë sa më gjatë, që mund të riparohet në rast mosfunksionimi dhe pjesët e të cilit do të përdoren për qëllime të tjera kur riparimi nuk është më i mundur. Ne planifikojmë paraprakisht përdorimin e të gjitha lëndëve të para edhe për qëllime të tjera, p.sh. si pjesë këmbimi për riparimin e frigoriferëve të tjerë; ne planifikojmë metalet e përdorura për prodhimin e frigoriferëve të rinj, dhe disa pjesë mund të përdoren për prodhimin e energjisë. Dhe vetëm materialet absolutisht të papërdorshme do të përfundojnë në një landfill.

Për të pasur një ekonomi qarkulluese, ne kemi nevojë për menaxhim modern të mbetjeve (ndarja e letrës, metaleve, plastikës, qelqit dhe mbetjeve bio). Për sa i përket riciklimit, Serbia mbetet poshtë mesatares së BE-së, pasi një banor mesatar i rajonit tonë riciklon më pak se 3% të produkteve me të cilat bie në kontakt, ndërsa mesatarja evropiane është deri në 44%. Sllovenët, për shembull, riciklojnë deri në 42.5% të produkteve që përdorin<sup>4</sup>.

Ekonomia qarkulluese i trajton mbetjet si burim. Kjo mënyrë e funksionimit të ekonomisë ka përparësi të shumta, si për natyrën ashtu edhe për njerëzit. Para së gjithash, parandalon gjenerimin e mbeturinave që shohim përreth nesh, në vendepozitimet përgjatë rrugëve, në lumenj apo pyje. Më pas mundëson krijimin e vendeve të reja të punës (për shembull në riparim, riciklim ose sektorë të tjerë) dhe promovon përdorimin e lëndëve të para të disponueshme në vend. Zhvillimi i mëtejshëm i bazuar në parimet e ekonomisë qarkulluese ka potencial të madh për vendet e Ballkanit Perëndimor. Me vendet e reja të punës, përmes zbatimit të parimeve të ekonomisë qarkulluese, edhe ekonomia e rajonit tonë do të bëhet më produktive. Aktualisht jemi poshtë mesatares evropiane, pasi për të njëjtën sasi burimesh natyrore të shfrytëzuara prodhojmë deri në 7 herë më pak vlerë ekonomike<sup>5</sup>.

### 3. LUFTA KUNDËR NDOTJES SË UJIT, AJRIT DHE TOKËS

Sot jemi në gjendje të lançojmë një aplikacion në celular dhe të shohim ikonën e një personi të qeshur, ose më shpesh kohët e fundit, të atij që mban maskë gazi, gjë që tregon se ajri është tepër i ndotur dhe se nuk duhet të dalim jashtë. Qytetarët e Ballkanit Perëndimor janë shumë më të ekspozuar ndaj ndotjes së ajrit sesa qytetarët e pjesëve të tjera të Evropës. Mbi 30,000 njerëz në Ballkanin Perëndimor humbin jetën para kohe çdo vit për shkak të përqendrimeve të larta të grimcave pezull në ajër<sup>6</sup>.

Qytetarët shpesh pyesin veten – si mund të jemi të sigurt se po marrim të dhëna të sakta? Axhenda e Gjelbër parashikon ngritjen e sistemeve të besueshme dhe moderne të monitorimit të cilësisë së ajrit, harmonizimin e tyre me standardet evropiane, si dhe formalizimin e bashkëpunimit rajonal për monitorimin e ndotësve. Axhenda e Gjelbër na jep mbështetje për të reduktuar emetimet e ndotësve në ajër dhe për të aplikuar standarde që mbrojnë mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve. Megjithatë, përveç teknologjisë, standardeve dhe rregulloreve, Axhenda e Gjelbër insiston në



#BallkaniIBashkuarPërAjërtëPastër

angazhimin dhe bashkëpunimin politik të qeverive rajonale.

Gjithashtu, nuk mjafton që këto detyrime të kufizohen vetëm për sektorin e ajrit. Ne duhet të zbatojmë të njëjtin parim të bashkëpunimit dhe monitorimit rajonal për ujin dhe tokën. Merrni, për shembull, banorët e një zone rurale rreth Danubit. Për shkak të afërsisë së lumit, ata kanë akses në ujë të pijshëm, por në përgjithësi nuk përfshihen në sistemin e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Prandaj, ujërat e ndotura të tyre shkojnë drejtpërdrejt në rezervuarët nëntokësorë ose në ujërat sipërfaqësore. Ata përdorin ujë nga të njëjtat burime për të pirë dhe për ujitje të fushave dhe pemëve, por shpesh nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë për shkak të niveleve të tepërta të nitrateve ose përbërjes së papërshtatshme bakteriologjike. Prandaj, është i nevojshëm zhvillimi i teknologjive të trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat do të kontribuonin në mbrojtjen e të gjithë rrjedhave të lumenjve dhe që popullsia të ketë akses në ujë të pijshëm. Në këtë rast, bashkëpunimi rajonal i vendeve që ndajnë një lumë të caktuar është i një rëndësie të madhe, në mënyrë që projektet dhe zgjidhjet e përbashkëta të ndihmojnë në ruajtjen

<sup>4</sup> <https://balkangreenenergynews.com/slovenia-ranks-third-on-list-of-top-10-countries-with-most-recycled-waste/>

<sup>5</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/green\\_agenda\\_for\\_the\\_western\\_balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf), p. 7

<sup>6</sup> EEA – Air Quality in Europe in 2020, p. 108

e cilësisë së rrjedhave ujore. Nga ana tjetër, toka shkatërrohet nga erozioni shumë herë më shpejt se sa proceset natyrore e rigjenerojnë atë. Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria janë veçanërisht të prekura nga erozioni. Shqipëria humbet rreth 45 hektarë tokë në vit, ndërsa 80% e tokës bujqësore në Serbi është e rrezikuara. Së fundi, në Mal të Zi rrezikohet edhe Gjiri i Kotorrit për shkak të ndikimeve të ndryshme të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore. Axhenda e Gjelbër thekson rëndësinë e pyllëzimit si një nga mënyrat për të luftuar procesin e erozionit. Pyjet rregullojnë rrjedhjen e ujit, thithjen dhe ruajtjen e përhershme të tij.

#### 4. PRODHIMI I USHQIMIT TË SHËNDETSHËM

Duke qenë se toka, ashtu si uji, është baza për bujqësinë e të gjithë rajonit, kjo shtyllë e Axhendës së Gjelbër logjikisht pasohet nga ajo e radhës, përkatësisht mbrojtja e prodhimit bujqësor.

Bujqësia, së bashku me blegtorinë, pylltarinë dhe peshkimin, është historikisht një pjesë shumë e rëndësishme e jetës së njerëzve në këtë



#BallkaniiBashkuarPërAjërtëPastër

zonë, si për prodhuesit ashtu edhe për konsumatorët. Në Ballkanin Perëndimor, prodhuesit e vegjël vazhdojnë të përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të prodhimit të ushqimit, nga ku bujqësia kontribuon rreth 10% të prodhimit të brendshëm bruto të rajonit. Zbatimi i Axhendës së

Gjelbër do të nënkuptonte prodhimin e ushqimit më cilësor, në mënyrë që të mos dëmtojë mjedisin dhe me përdorimin e risive teknologjike. Kështu, për shembull, fermerët nga rajoni ynë mund të përmirësojnë produktivitetin e tyre duke monitoruar të dhënat e marra nëpërmjet imazheve satelitore, për fatkeqësitë e mundshme të motit, të cilat do t'i lejojnë ata të mbrojnë të korrat e tyre në kohën e duhur. Nga ana tjetër, një analizë e detajuar e kushteve të motit në Ballkanin Perëndimor, si dhe një e specieve bimore dhe shtazore dhe përhapja e disa dëmtuesve, mund t'i ndihmojë fermerët të zgjedhin kulturat potencialisht më të suksesshme për fushat e tyre. Një parim i tillë do të kontribuonte gjithashtu në zvogëlimin e përdorimit të pesticideve, plehrave dhe agjentëve të tjerë, duke parandaluar ndotjen e tokës dhe të ujit, dhe duke reduktuar ndikimin negativ të bujqësisë në mjedis. Në këtë mënyrë, cilësia e ushqimit që hamë do të përmirësohej dhe përdorimi i inovacioneve teknologjike do të rriste cilësinë e produkteve bujqësore të përpunuara. Përpunimi i ushqimit do të duhet të shoqërohet edhe me përmirësime në etiketimin transparent të përmbajtjes së produktit, gjë që do të na mundësonte ne, konsumatorët, të jemi më të informuar kur zgjedhim ushqimin që konsumojmë dhe blejmë.

#### 5. BIODIVERSITETI: MBROJTJA DHE RESTAURIMI I NATYRËS DHE EKOSISTEMEVE

Duke përshtatur përdorimin e pesticideve, shumë insekte do të jenë më pak

të rrezikuara, gjë që është e rëndësishme për shtyllën e pestë të Axhendës së Gjelbër, përkatësisht mbrojtjen dhe restaurimin e biodiversitetit dhe ekosistemeve.

Natyrë mundëson jetën në tokë siç e njohim ne: siguron ujë, ushqim, ajër të pastër, substanca medicinale, na mbron nga fatkeqësitë e ndryshme, si përmytjet apo stuhitë, rregullon ndryshimin e stinëve dhe kushteve të motit nga të cilat varem. E gjithë kjo na vjen nga natyra dhe këto shërbime të ekosistemit nga të cilat varet ekzistenca e shoqërisë sonë shpesh merren si të mirëqena.

Pse është i rëndësishëm për ne biodiversiteti? Biodiversiteti është, në fakt, diversiteti i florës dhe faunës që na rrethon, dhe sa më i madh ai diversitet, aq më rezistente është natyra ndaj zjarreve, përmytjeve, sëmundjeve dhe ndryshimeve klimatike. Sa më fleksibël të jetë natyra, aq më shumë është në gjendje të vazhdojë të na ofrojë të gjitha shërbimet e ekosistemit nga të cilat ne varem. Kështu, për shembull, pyjet e pasura dhe të larmishme bregdetare parandalojnë përmytjet ose ulin intensitetin e tyre. Një shumëllojshmëri më e madhe e insekteve pjalmuese mund të kontribuojë në pjalmimin më të suksesshëm të frutave dhe bimëve të tjera që ne rrisim, dhe në këtë mënyrë të rrisë rendimentin e ushqimit. Ballkani Perëndimor mund të mburret me një pasuri të habitateve dhe specieve; kjo pjesë e Evropës është shtëpia e shumë specieve që jetojnë vetëm këtu, në rajonin tonë, dhe që ne i quajmë specie endemike. Të gjitha ato janë të nevojshme për të mbështetur shërbimet e ekosistemit nga të cilat ne varem.



#BallkaniiBashkuarPërAjërtëPastër

Shtylla e pestë e Axhendës së Gjelbër synon të ndalojë humbjen e biodiversitetit, shpyllëzimin e mëtejshëm dhe humbjen e tokës, dhe të mundësojë restaurimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit në Ballkanin Perëndimor. Për ta arritur këtë, është e nevojshme që vendet e rajonit tonë të zhvillojnë së bashku plane strategjike për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe t'i zbatojnë ato së bashku. Gjithashtu duhet të krijojmë plane të përbashkëta për rinovimin e sipërfaqeve pyjore, si dhe parandalimin e shpyllëzimit, i cili aktualisht është një problem i madh në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të përmirësuar më tej ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve, Axhenda e Gjelbër do të inkurajojë bashkëpunimin midis vendeve tona, veçanërisht midis institucioneve që merren me mbrojtjen e natyrës dhe kërkimin, me qëllim krijimin e një Qendre të përbashkët Informativ për Biodiversitetin e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i këtij bashkëpunimi, si dhe qëllimi i krijimit të një qendre të përbashkët informacioni, është të eksplorojë mundësitë dhe mënyrat e ruajtjes së biodiversitetit, si dhe mundësitë e zhvillimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë për t'u mbrojtur nga efektet e ndryshimeve klimatike.

Marko Pajović, Tatjana Avramović, Lazar Jovčić, Mirjana Jovanović, Ognjan Pantić for the Balkans United for Clean Air network, European Fund for the Balkans 2022. All rights reserved. The views expressed in this publication are those of the author(s) and do not necessarily represent the positions or views of the European Fund for the Balkans.

You are welcome to quote and use these finding in your own published work on the condition that you cite EFB as commissioner of the research, and provide a link to the publication on the EFB website:

[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)

# BALKANS UNITED FOR CLEAN AIR



UJEDINJEN BALKAN  
ZA ČIST ZRAK

BALLKANI I BASHKUAR  
PËR AJËR TË PASTËR

ОБЕДИНЕТ БАЛКАН  
ЗА ЧИСТ ВОЗДУХ

UJEDINJEN BALKAN  
ZA ČIST VAZDUH



PRINTED ON RECYCLED PAPER